





№ 5515 prot
19.12.2025



RAPORTI I PERFORMANCËS 2025



BASHKIA RROGOZHINË

Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

Fjalor Shpjegues	4
QËLLIMI I RAPORTIT	6
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË	6
TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË.....	7
SHËRBIME PUBLIKE VENDORE.....	8
Arsimi Paraniversitar.....	9
Menaxhimi i Mbetjeve	11
Mbrojtja nga zjarri	13
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	14
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	16
MBROJTJA SOCIALE	17
QEVERISJA E MIRË	21
Burimet Njerëzore	21
Transparenca	23
Barazia Gjinore	24
Integrimi në BE	26
MENAXHIMI FINANCIAR	28
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	31

FJALOR SHPJEGUES

Disagregim

Është procesi i ndarjes së të dhënave sipas kategorive të veçanta (si gjinia, mosha, vendbanimi urban/rural, tipi i institucionit publik/privat etj.) me qëllim që të kuptohet më mirë shpërndarja dhe ndikimi i një shërbimi ose fenomeni. Disagregimi ndihmon për të evidentuar pabarazitë, për të krahasuar grupet e ndryshme dhe për të planifikuar politika apo ndërhyrje më të drejtura dhe gjithëpërfshirëse.

Funksion

Është fusha e veprimtarisë, për të cilën njësi e vetëqeverisjes vendore është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ta ushtruar lirisht, tërësisht apo në një pjesë të tij, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore

Nën-Tregues

Një nën-tregues është një element më i detajuar i një treguesi kryesor, që shërben për ta shpërbërë dhe matur më saktësisht një aspekt të veçantë të tij. Nën-treguesit ndihmojnë në kuptimin më të thelluar të performancës, duke dhënë informacion të ndarë sipas gjinive, zonave gjeografike, llojit të shërbimit (publik/privat) apo kritereve të tjera të disagregimit.

Produkt

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Qeverisja e Mirë

I referohet parimeve dhe praktikave që garantojnë funksionimin efikas, transparent, gjithëpërfshirës dhe të drejtë të një bashkie. Në këtë kuadër përfshihen elementë si transparenca publike, barazia gjinore, integritimi në BE, pjesëmarrja qytetare, profesionalizmi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i qëndrueshëm financiar.

Sistemi i Matjes së Performancës

Është mekanizmi kombëtar dhe vendor për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi ofrimin e shërbimeve nga bashkitë. Ky sistem përfshin një grup treguesish dhe nën-treguesish të standardizuar, që përdoren për të krahasuar performancën e bashkive, për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe për të mbështetur vendimmarrjen e bazuar në evidencë.

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 33, çdo bashki është e detyruar të krijojë një sistem të brendshëm matjeje dhe raportimi mbi performancën e saj, në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike, përdorimin e burimeve dhe realizimin e objektivave. Ky sistem vendor lidhet ngushtë me sistemin kombëtar, duke mundësuar harmonizimin e të dhënave dhe krahasimin mes njësive të vetëqeverisjes vendore.

Sherbime Publike Vendore

Janë shërbimet që ofrohen nga bashkia për komunitetin, në përputhje me funksionet e përcaktuara nga ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këto përfshijnë, ndër të tjera, ndriçimin publik, arsimin parashkollor dhe çerdhet, mbrojtjen sociale, menaxhimin e mbetjeve, pyjeve e kullotave dhe ujtitjen dhe kullimin etj. Sipas përkufizimit të ligjit "janë ato shërbime me interes të përgjithshëm publik, të cilat ofrohen për komunitetin nga bashkitë, në mënyrë të vazhdueshme, me çmime të përballueshme, sipas standardeve minimale kombëtare, të përcaktuara me ligj apo me akte të tjera normative"

Tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Të Dhëna

Janë informacionet e mbledhura nga burime zyrtare të bashkisë ose institucione të tjera, që shërbejnë si bazë për llogaritjen e treguesve të performancës. Të dhënat mund të jenë numerike (statistika mbi popullsinë, buxhetin, shkollat etj.) ose cilësore (planifikime, raporte, dokumente strategjike) dhe janë të domosdoshme për analizën dhe raportimin e performancës.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për çfarëdo zë apo projekt).

QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti i Performancës 2025 bazohet në të dhënat e Sistemit të Matjes së Performancës 2023-2024 dhe synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar mbi performancën e bashkisë në 11 fusha funksionale. Ky raport përdoret për të ndihmuar vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien, si dhe për të mundësuar krahasimin ndërmjet bashkive në nivel kombëtar.

Ky raport është përgatitur nga Bashkia Rrogozhinë, i mandatuar nga Kryetari i Bashkisë në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, Neni 33, si dhe në kuadër të Sistemit Kombëtar të Matjes së Performancës (SMP 2025).

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI BASHKINË

Bashkia e Rrogozhinës shtrihet në një terren pjesërisht kodrinor dhe pjesërisht fushor deri në bregun e detit. Bashkia ka për qendër qytetin e Rrogozhinës. Rrogozhina kufizohet në veri me Bashkinë Kavajë, në veri-lindje me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Lushnjë dhe Divjak, në lindje me Bashkinë Peqin dhe në perëndim me Detin Adriatik. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Rrogozhinës. Bashkia ka një sipërfaqe prej 223.5 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km².

Ekonomia e Bashkisë është fokusuar në dy shtylla kryesore në bujqësi ku 70% e territorit është bujqësore dhe turizëm ku disponon 20 kilometër vijë bregdetare. Hartimi i planeve të duhura zhvillimore, të shoqëruara me investimet e përshtatshme për rrugë, kanalizime, ndriçim dhe ujë të pijshëm ofron një mundësi për rritjen e të ardhurave të bashkisë.

Rrogozhina e sotme, e pozicionuar midis Durrësit, Lushnjës dhe Elbasanit, është nyje e rëndësishme e korridorit të 8-të, dhe e kryqëzimit hekurudhor Rrogozhinë-Durrës, Rrogozhinë-Vlorë dhe Rrogozhinë – Pogradec. Midis viteve 1960-1990, qyteti i Rrogozhinës kishte disa prej fabrikave më të rëndësishme të prodhimit, si ajo e vaj-sapunit ku prodhohej vaji i lulediellit dhe ku kishte linjë të përpunim-konservimit të ushqimeve, midis së cilave edhe një fabrikë makaronash. Uzina e zhveshjes së pambukut, ku vinte pothuaj i gjithë prodhimi vendas i pambukut, si edhe punishtja e përpunimit të bimëve mjekësore dhe etero-vajore e renditën qytetin përsëri krah qyteteve të tjera të rëndësishme të industrisë së lehtë dhe prodhimit ekonomik.

TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BASHKISË

E DHËNA	Viti 2024
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë	27195
Popullsia në qytet	10548
Popullsia në njësitë administrative	16647
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	223.5
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²	
Sipërfaqja e njësive administrative në total	

Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	2213
Sipërfaqe totale e fondit kullësor (në ha)	922
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	13180
Numri total i njësive administrative të bashkisë	5
Numri i fshatrave	38
Punonjës të bashkisë në total	310
Numri total i punonjësve femra të bashkisë	133
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë	177
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë	240
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë	

SHËRBIME PUBLIKE VENDORE

Ky kapitull paraqet performancën e bashkisë në ofrimin e shërbimeve publike vendore, të cilat përbëjnë thelbin e përgjegjësiave të saj sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në këtë kuadër, janë trajtuar gjashtë fusha kryesore të aprovuara edhe në kuadër të raportit kombëtar të performancës bashkiake, që përfshijnë gjithsej 10 funksione: arsimi parauniversitar (ku hyjnë çerdhet, arsimi parashkollor dhe infrastruktura e godinave arsimore), ujitja dhe kullimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, menaxhimi i mbetjeve, mbrojtja nga zjarri, mbrojtja civile, si dhe mbrojtja sociale, e cila përfshin katër shërbime të detyrueshme sipas nenit 24 të ligjit.

Matja e performancës në këto fusha bazohet në tregues të standardizuar sipas SMP Kombëtar, tregues të tjerë vendor që janë përzgjedhur nga bashkia, si dhe nën-tregues të detajuar, të cilët ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi aksesin e qytetarëve në shërbime, cilësinë dhe kapacitetet e tyre, si dhe barazinë në ofrim ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore. Përmes këtij sistemi, bashkia ka mundësi të identifikojë përparimet e arritura, sfidat e mbetura dhe nevojat për përmirësim në ofrimin e shërbimeve themelore për komunitetin.



ARSIMI PARAUNIVERSITAR

Përshkrim i përgjithshëm: Arsimi parauniversitar në nivel vendor përfshin shërbimet e arsimit të hershëm (çerdhe dhe kopshte), arsimin bazë 9-vjeçar dhe arsimin e mesëm të përgjithshëm. Kompetencat për administrimin dhe zhvillimin e këtij sektori janë të deleguara te njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Dy funksionet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:

- Funksioni 23.11: "Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale."
- Funksioni 23.12: "Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe."

Në këtë kuadër, bashkitë janë përgjegjëse njëkohësisht për aspektet infrastrukturore dhe menaxheriale të institucioneve arsimore nën juridiksionin e tyre. Kjo përfshin ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore, si dhe administrimin e plotë të sistemit parashkollor (kopshte dhe çerdhe) përmes funksionit, që përfshin menaxhimin e stafit ndihmës, mbështetjen logjistike dhe rregullimin funksional të shërbimit.

Në këtë seksion janë monitoruar 5 tregues kryesorë dhe 4 nën-tregues, të cilët mbulojnë qasjen në arsim (regjistrimin në çerdhe dhe kopshte publike e private), cilësinë e shërbimit (raportin fëmijë-mësues) si dhe gjendjen e infrastrukturës arsimore.

Në përgjithësi, vitin 2024 e karakterizon një trend pozitiv në arsimin parauniversitar. Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike u rrit nga 18.33% në 21.67%, ndërsa në kopshte publike arriti 88.5%, duke reflektuar rritje të aksesit në institucionet edukative me 18% përsa i përket çerdheve dhe me 6% përsa i përket kopshteve. Numri i godinave arsimore sipas nivelit arsimor për të dy vitet vijon të qendrojë i njëjtë duke treguar mungesë të investimeve në infrastrukturën arsimore.

Nga ana tjetër ka edhe një përkeqësim të raportit fëmijë-mësues nga 10.81 në 11.42 që është një tregues i uljes së cilësisë së kujdesit për këtë shërim ndaj fëmijëve. Bashkia duhet të marrë masa që të monitorojë këtë raport dhe të adresojë cdo problematikë, pasi me shtimin e numrit të fëmijëve që regjistrohen në çerdhe dhe kopshte duhet të shtohet edhe numri i edukatorëve për të siguruar shërbim cilësor në këto institucione. Element pozitiv është zbatimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike	%	18.33	21.67	3.33	↑	Përmirësuar	●	18%
Tregues	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private	%	83.75	88.50	4.75	↑	Përmirësuar	●	6%
Tregues	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	Po=1/Jo=0	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike dhe private	fëmijë/mësues	10.81	11.42	0.61	↑	Përkeqësuar	●	6%
Tregues	Godina Arsimore sipas nivelit arsimor	numër	36.00	36.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Godina Arsimore publike sipas nivelit arsimor	numër	36.00	36.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Godina Arsimore private sipas nivelit arsimor	numër	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	fëmijë/mësues	10.81	11.42	0.61	↑	Përkeqësuar	●	6%
Nen-tregues	Raporti fëmijë-mësues në kopshte private	fëmijë/mësues	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim		

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i fëmijëve të moshës nga 6 muaj-3 vjeç në bashki	180.00	180.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 6 muaj deri në 3 vjeç të regjistruar në çerdhe publike	33.00	39.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës nga 3-6 vjeç në bashki	400.00	400.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet publike	335.00	354.00	Numër
Numri i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç që frekuentojnë kopshtet private	0.00	0.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte publike	31.00	31.00	Numër
Numri i edukatorëve në kopshte private	0.00	0.00	Numër
Numri i çerdheve publike në bashki	1.00	1.00	Numër
Numri i çerdheve private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i kopshteve publike në bashki	18.00	18.00	Numër
Numri i kopshteve private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare publike në bashki	15.00	15.00	Numër
Numri i shkollave 9-vjeçare private në bashki	0.00	0.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme publike në bashki	2.00	2.00	Numër
Numri i shkollave të mesme të përgjithshme private në bashki	0.00	0.00	Numër
Plani vendor i Arsimit Parauniversitar, I miratuar ose zbatuar	1.00	1.00	Po=1 / Jo=0

Shënim: Një pjesë e të dhënave janë plotësuar nga SMP 2023 e realizuar në bashkëpunim me AMVV

MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Ky funksion përfshin të gjitha aspektet që lidhen me mbledhjen, largimin, transportin, trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e pastërtisë në hapësirat publike si rrugët, sheshet, tregjet dhe parqet. Nëpërmjet këtij funksioni, bashkitë sigurojnë krijimin dhe operimin e sistemeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë strukturat teknike, logjistikën, kontraktimin e subjekteve private dhe kontrollin e zbatimit të standardeve mjedisore.

Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, i cili i njeh bashkive kompetencën për menaxhimin e shërbimeve publike vendore, përfshirë menaxhimin e mbetjeve urbane dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike.

Për këtë shërbim janë monitoruar 4 tregues kryesorë dhe 2 nën-tregues, të cilët përfshijnë mbulimin e popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale dhe urbane, shpenzimet për këtë administrim, volumnin e mbetjeve për banor si dhe hartimi i dokumentit strategjik për këtë funksion.

Të dhënat tregojnë një situatë të ndërlikuar në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Mbulimi i popullsisë me shërbim në nivel të përgjithshëm ka mbetur i pandryshuar (80.2%), ndërsa zona urbane kanë një

mbulim 100% të qëndrueshëm, zonat rurale vijon të mbetet në nivel të ulët të mbulimit me këtë shërbim dhe pa bërë progres (60.53%).

Sasia e mbetjeve të gjeneruara për banor ka pësuar një rënie prej -52%. Kjo ulje shumë e madhe interpretohet nga Bashkia si efekt i ndryshimeve në metodologjinë e matjes. Gjatë 2023 është përdorur një metodë vlerësimi e sasisë së mbetjeve ndërsa gjatë 2024 është përdorur peshimi i sasisë së mbetjeve. Gjithashtu mbulimi i kostove të menaxhimit të mbetjeve ka rënë me 43%, duke treguar dobësim të qëndrueshmërisë financiare të sistemit dhe rritje të varësisë nga transfertat. Situata institucionale dhe strategjike është përmirësuar pas miratimit të planit vendor të menaxhimit të mbetjeve, i cili synon një mbulim më të gjërë të shërbimit në zonat urbane dhe rurale, si edhe një shpërndarje më eficiente të burimeve financiare dhe njerëzore për të përmirësuar këtë shërbim.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale	%	80.26	80.26	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Mbetjet e gjeneruara si kg/banor	kg/banor	227.50	108.98	-118.52	↓	Përmirësuar		-52%
Tregues	Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit	%	46.76	26.46	-20.30	↓	Përkeqësuar	●	-43%
Tregues	Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve i miratuar ose në zbatim	Po=1 Jo=0	0.00	1.00	1.00	↑	Përmirësuar	●	
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Nen-tregues	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale	%	60.53	60.53	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) Të dhënat

Edhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri njësive administrative qendër (qytete) të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	1.00	1.00	Numër
Numri njësive administrative qendër (qytete) të bashkisë	1.00	1.00	Numër
Numri fshtrave të mbuluar me shërbimin e mbetjeve	23.00	23.00	Numër
Numri fshatrave në territorin e bashkisë	38.00	38.00	Numër
Sasia e mbetjeve të gjeneruara gjithsej	6479500.00	2963770.00	Kg
Të ardhurat gjithsej nga tarifa e shërbimit të mbetjeve	19035.80	18274.00	mijë Lekë
Shpenzime gjithsej për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	40710.00	69072.00	mijë Lekë
Plani i miratuar ose zbatuar gjatë vitit të raportimit	0.00	1.00	Po=1/Jo=0
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	28481.00	27195.00	Numër

MBROJTJA NGA ZJARRI

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë përgjegjësi për garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe për administrimin e strukturave përkatëse të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit. Ky funksion synon të sigurojë reagim të shpejtë dhe efektiv në raste emergjencash, si dhe të ndërtojë kapacitete vendore për parandalimin e zjarreve në mjedise urbane, rurale dhe pyjore. Përgjegjësitë e bashkive përfshijnë operimin dhe mirëmbajtjen e njësive zjarrfikëse, organizimin e shërbimeve parandaluese, si dhe bashkëpunimin me strukturat qendrore për raste që tejkalojnë kapacitetet vendore. Bashkitë gjithashtu angazhohen në edukimin e komunitetit dhe trajnimin e stafit për reagim dhe menaxhim të rreziqeve nga zjarret.

Në këtë seksion janë monitoruar 2 tregues kryesorë, të cilët fokusohen tek performanca e Bashkisë mbi shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, me fokus automjetet dhe zjarrfikësit në dispozicion në raport me popullsinë.

Për vitin 2024 ky shërbim paraqet me përmirësim përse i përket numrit të punonjësve i cili është rritur më 27% që mund të ketë ardhur si rezultat i riorganizimit të burimeve njerëzore të mbrojtjes nga zjarri. Përse i përket flotës së automjeteve për të njëjtin vit ka një përgjysmim të numrit të mjeteve zjarrfikëse për popullsi, pasi një prej automjeteve është transferuar për përdorim tek një institucion tjetër (Burgu Rogozhinë).

Në terma të menaxhimit të riskut dhe kapaciteteve të emergjencës, treguesi i automjeteve ka peshë më të madhe direkte mbi aftësinë për të menaxhuar zjarren. Për këtë arsye, pavarësisht përmirësimit të stafit, rënia e flotës e mbingarkon shërbimin dhe ul nivelin e sigurisë publike.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor %	Ndryshimi
Tregues	Zjarrëfikës për 1,500 banorë	punonjës/1500 banorë	0.74	0.94	0.20	↑	Përmirësuar	●	27%
Tregues	Automjete zjarrëfikëse për 10,000 banorë	mjete/10000 banorë	0.70	0.37	-0.33	↓	Përkeqësuar	●	-47%

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve zjarrëfikës në bashki	14.00	17.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	28481.00	27195.00	Numër
Numri i mjeteve zjarrëfikëse funksionale në bashki	2.00	1.00	Numër

MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i përgjithshëm: Funkzioni për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është pjesë e kompetencave të deleguara të NJVV-të sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 27 pika 1. Ky funksion përfshin ndërtimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ujitjes dhe kullimit në territorin e bashkisë, si dhe përgatitjen e planeve vendore për menaxhimin e qëndrueshëm të rrjeteve përkatëse. Qëllimi i këtij funksioni është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe mbrojtja e konsumatorëve përmes garantimit të furnizimit me ujë për vaditje dhe menaxhimit të ujërave të tepërta në zonat bujqësore.

Për menaxhimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit janë monitoruar 2 tregues kryesorë dhe 2 nën-tregues, të cilët përfshijnë mbulimin e sipërfaqes bujqësore me ujitje dhe kullim si dhe raporti i kanaleveujtëse dhe kulluese me gjatësinë e kanaleve funksionale

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore në bashki ka mbetur e pandryshuar (13,180 ha), po ashtu edhe sipërfaqja e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi jon të mbetet e njëjtë. Gjatësia totale e kanaleve ujitëse ka rënë paksa nga 94.20 km në 93.30 km, dhe e njëjta gjë vlen edhe për kanalet ujitëse funksionale, të cilat kanë rënë në të njëjtën masë. Ndryshimi është i vogël (~1 km) dhe tregon një jo përkeqësim serioz në infrastrukturën e ujitjes. Megjithatë, fakti që kanalet funksionale janë saktësisht sa

kanalet totale sugjeron se raportimi mund të jetë nominal, ose rrjeti i ujitjes është i vogël dhe relativisht i mirëmbajtur. Sidoqoftë, ky volum është shumë i ulët për një sipërfaqe kaq të madhe bujqësore.

Gjatësia e kanaleve kulluese ka rënë në mënyrë drastike me — nga 247.60 km në vetëm 83 km. Po aq e madhe është rënia edhe për kanalet kulluese funksionale. Kjo përfaqëson një ulje prej rreth 66% të infrastrukturës së kullimit, duke krijuar një risk shumë të lartë për përmytje të tokave bujqësore, rënie të prodhimit dhe cilësisë së tokës, dëmtime të kulturave bujqësore në periudha reshesh intensive, etj. Kjo ulje masive është tregues i një problemi serioz në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit të drenazhimit.

A) Lista e Detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor %	Ndryshimi
Tregues	Tokë bujqësore e pajisur me kanale ujitje/kullimi	%	45.79	45.79	0.00	→	Pa ndryshim	●	-54%
Tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse dhe kulluese funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve ujitëse funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Nen-tregues	Përqindja e kanaleve kulluese funksionale	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Sipërfaqja gjithsej e tokës bujqësore në bashki	13180.00	13180.00	Hektarë
Sipërfaqja e tokës bujqësore e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi	6035.00	6035.00	Hektarë
Gjatësia e kanaleve ujitëse	94.20	93.30	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve ujitëse funksionale	94.20	93.30	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese	247.60	83.00	Kilometër (km)
Gjatësia e kanaleve kulluese funksionale	247.60	83.00	Kilometër (km)

ADMINISTRIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrim i përgjithshëm : Funkzioni i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, sipas nenit 27, pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i është deleguar bashkive me qëllim administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor publik që ndodhet brenda territorit të NJVV-ve. Bashkitë janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit për fondet, monitorimin e tyre dhe për sigurimin e mbrojtjes kundër dëmtimeve, ndotjes apo zjarreve, në përputhje me legjislacionin për pyjet dhe kullotat.

Lidhur me administrimin e pyjeve dhe kullotave janë monitoruar 3 tregues kryesorë, me fokus kryesor mbulimin e fondit pyjor dhe kullor me plan mbarështimi dhe raporti i punonjësve për këtë shërbim.

Të dhënat tregojnë se bashkia nuk ka asnjë plan mbarështimi të miratuar ose të zbatuar për fondin pyjor dhe kullor (vlera 0 për të dy vitet). Kjo është një mangësi kritike, pasi planet e mbarështimit janë dokumentet bazë që përcaktojnë mënyrën e administrimit, planifikimit të prerjeve, ripyllëzimeve, kullotjes, masave mbrojtëse dhe të gjitha ndërhyrjeve në territor. Mungesa e një plani do të thotë se menaxhimi kryhet pa orientim teknik dhe pa dokumentacion të domosdoshëm ligjor.

Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullor, nuk ka ndryshime por është përmirësuar raporti punonjës për 1000 ha duke shënuar një rritje me 35%. Gjithashtu edhe numri i punonjësve është rritur nga 3 në 4, por ky staf mbetet shumë i pamjaftueshëm për të administruar një sipërfaqe të konsiderueshme, edhe nëse merret si referencë vlera e re më e ulët. Edhe në rastin më të mirë, treguesit sugjerojnë një administrim minimalist, më tepër formal sesa funksional.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Plan Vendor Mbarështimi i miratuar ose zbatuar	Po=1 Jo=0	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi	%	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Punonjës për 1,000 hektarë	punonjës/ 1000 ha	0.95	1.28	0.33	↑	Përmirësuar	●	35%

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Plan Vendor Mbarështimi I miratuar ose zbatuar	0.00	0.00	Po=1/Jo=0
Sipërfaqja gjithsej e fondit pyjor dhe kullosor në bashki	3135.00	3135.00	Hektarë
Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor e mbuluar me plan mbarështimi	0.00	0.00	Hektarë
Numri i punonjësve për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	3.00	4.00	Numër

MBROJTJA SOCIALE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale vendore për individët dhe familjet në nevojë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, fëmijët pa përkujdesje prindërore, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe grupet e tjera vulnerabël. Shërbimet përfshijnë ndihma financiare dhe në natyrë, mbështetje për strehim dhe përfshirje sociale, si dhe funksionimin e qendrave ditore apo rezidenciale. Qëllimi i tyre është të lehtësojnë jetesën dhe të nxisin integrimin e qytetarëve në komunitet. Ndër shërbimet kryesore përfshihen: pagesat për kujdestari dhe lindje, ndihma për energji dhe nevoja bazë, shërbime për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara, mbështetje në kushte emergjente, strehim të përkohshëm dhe përkujdesje në shtëpi, si dhe masa për riintegrimin e të papunëve në tregun e punës. Bashkitë gjithashtu bashkëpunojnë me Organizata jo Fitimprurëse (OJF) dhe sektorin privat për ofrimin e këtyre shërbimeve në territor.

Ky funksion rrjedh nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 24 që përcakton se Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.
- Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Për mbrojtjen sociale janë monitoruar 6 tregues kryesorë dhe 11 nën-tregues, të cilët mbulojnë shkallën e miratimit të ndihmës ekonomike dhe strehimit social, si dhe mbulimin me shërbime sociale.

Ndihma ekonomike për familjet ka shënuar një rritje të moderuar të aplikimeve (nga 214 në 240) dhe të përfituesve (nga 214 në 229), duke treguar një përgjigje pozitive të bashkisë. Megjithatë, ekziston një hendek i vogël midis aplikimeve dhe përfituesve, që tregon nevojën për rishikim të kriterëve ose kapaciteteve financiare.

Programet e strehimit social kanë shënuar një rënie të aplikimeve (nga 43 në 25), ndërsa të gjithë aplikantët e vitit 2024 kanë përfituar shërbime. Mungesa e të dhënave për vitin 2023 e vështirëson krahasimin, por treguesi aktual tregon efikasitet në shpërndarje.

Shërbimet e tjera sociale kanë probleme të dukshme: mungojnë të dhëna për vitin 2023, numri i rasteve të dhunës të referuara në 2024 është 9, por vetëm një rast ka përfituar mbështetje; nga 29 persona PAK të referuar, vetëm 14 kanë marrë shërbime. Mungesa e qendrave sociale ditore dhe rezidenciale (0 funksionale) kufizon ndjeshëm mundësitë për ofrimin e shërbimeve për grupet vulnerabël.

Plani Vendor Social i hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2024 tregon progres institucional, por sfida mbetet zbatimi dhe monitorimi, sidomos kur ka vështirësi institucionale për mbledhjen e informacionit.

Për këtë shërbim Bashkia ka një mungesë të madhe të të dhënave për vitin 2023 dhe përlllogaritjet nuk mund të kryhen për të evidentuar zhvillimet gjatë 2023-2024 (semafori gri në tabelat më poshtë). Vihet re nevoja që Bashkia të rrisë më tej kapacitetet institucionale për mbledhjen, administrimin dhe raportimin e të dhënave, me qëllim sigurimin e informacionit të plotë dhe të besueshëm në proceset e raportimit, dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor %	Ndryshimi
Tregues	Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike	%	100.00	95.42	-4.58	↓	Përkeqësuar	●	-5%
Tregues	Shkalla e miratimit të strehimit social	%	0.00	100.00	100.00	↑	Përmirësuar	●	
Tregues	Numri i qendrave sociale komunitare publike, të licensuara për 10,000 banorë	Qendra /10,000 banorë	0	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Përqindja e rasteve të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%		11.11			Mungon	●	
Tregues	Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%		48.28			Mungon	●	
Tregues	Plan vendor social	Po=1 / Jo=0	0.00	1.00	1.00	↑	Përmirësuar	●	
Nen-tregues	Përqindja e rasteve femra të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%					Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e rasteve meshkuj të referuar nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%					Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 0-17 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%					Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 18-29 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr)	%					Mungon	●	

	që përfitojnë shërbime sociale								
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 30-44 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%		0.33			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 45-59 vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%		0.00			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e rasteve grupmosha 60+ vjeç të referuara nga mekanizmi i koordinuar i referimit (mkr) që përfitojnë shërbime sociale	%		0.00			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e femrave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%		0.50			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e meshkujve me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%		0.47			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 0-17 vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%	1.00	0.50	-0.50	↓	Përkeqësuar		-50%
Nen-tregues	Përqindja e personave grupmosha 18+ vjeç me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale të integruara	%					Mungon	●	

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike	214.00	240.00	Numër
Numri i familjeve përfituese të ndihmës ekonomike	214.00	229.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	28481.00	27195.00	Numër
Numri i personave që kanë paraqitur kërkesë për strehim social	43.00	25.00	Numër
Numri i personave përfitues të strehimit social	-	25.00	Numër
Numri i qendrave sociale ditore funksionale	-	0.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga Mekanizmit i Koordinuar i Referimit	-	9.00	Numër
Numri i rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës të referuara nga antarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR), të cilat kanë përfituar shërbime sociale	--	1.00	Numër
Numri i PAK të referuar nga shërbimet bio-psiko-sociale për të marrë shërbime sociale	-	29.00	Numër
Numri i PAK që marrin mbështetje si pasojë e referimit	-	14.00	Numër
Plani Vendor Social, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	-	1.00	Po=1/Jo=0

QEVERISJA E MIRE

BURIMET NJERËZORE

Përshkrim i përgjithshëm: Bashkitë kanë rol të rëndësishëm në menaxhimin e burimeve njerëzore për administratën vendore dhe strukturat e varësisë. Ky funksion përfshin planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, si dhe ndjekjen e dinamikave të personelit – duke përfshirë rekrutimin, rotacionin, trajnimin dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi stafin aktiv dhe të larguar. Qëllimi është të sigurohet një trupë administrative efektive, e kualifikuar dhe në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve publike vendore. Përmes këtij funksioni, bashkia ndjek tregues si numri i punonjësve për 1,000 banorë, përqindja e stafit të trajnuar, si dhe lëvizjet vjetore të stafit sipas gjinisë dhe njësisë strukturore (administratë ose njësi shpenzuese).

Gjatë periudhës së raportimit, numri i punonjësve të bashkisë ka rënë nga 341 në 310, ndërkohë që largimet janë rritur nga 31 në 43, duke reflektuar një trend të qartë të reduktimit të stafit. Kjo ka rritur shkallën e rotacionit të stafit nga 9.09% në 13.87%, që, nëse largimet kanë qenë vullnetare (pension, largim i dëshiruar), mund të sjellë përforcim të dinamikës së punës dhe qarkullim të ideve, por kërkon

menaxhim të kujdesshëm për të mos destabilizuar proceset administrative. Rënia e popullsisë së bashkisë nga 28,481 në 27,195 banorë ka ulur raportin punonjës/popullsi nga 11.97 në 11.4 punonjës për 1,000 banorë (-5%), duke rritur ngarkesën e punonjësve dhe potencialisht ndikimin mbi cilësinë e shërbimeve.

Nga perspektiva e menaxhimit të burimeve njerëzore, përpjekjet për zhvillim profesional kanë dhënë rezultate pozitive: përqindja e stafit të trajnuar është rritur nga 2.64% në 9.35%, duke rritur kapacitetin dhe efikasitetin e administratës. Gjithashtu, mungesa e stafit të nënkontraktuar (0 punonjës) tregon se të gjitha shërbimet janë ofruar nga stafi i brendshëm, gjë që ndihmon në kontrollin e cilësisë, por njëkohësisht vendos presion më të madh mbi stafin ekzistues. Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore duhet të balancojë reduktimin e stafit me zhvillimin profesional dhe shpërndarjen adekuate të detyrave për të ruajtur cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë	%	9.09	13.87	4.78	↑	Përkeqësuar	●	53%
Tregues	Përqindja e stafit të punësuar nga bashkia të trajnuar	%	2.64	9.35	6.72	↑	Përmirësuar	●	254%
Tregues	Punonjës për 1000 banorë	Punonjës /1,000 banorë	11.97	11.40	-0.57	↓	Përkeqësuar	●	-5%
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve femra të bashkisë	%		9.02			Mungon	●	
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve meshkuj të bashkisë	%		17.51			Mungon	●	
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të administratës të bashkisë	%		16.25			Mungon	●	
Nen-tregues	Shkalla e rotacionit të punonjësve të njësive shpenzuese të bashkisë	%		5.71			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e stafit femra të trajnuar	%		11.28			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e stafit meshkuj të trajnuar	%		7.91			Mungon	●	

Nen-tregues	Përqindja e stafit të administratës të trajnuar	%		10.42			Mungon	●	
Nen-tregues	Përqindja e stafit të njësive shpenzuese të trajnuar	%		5.71			Mungon	●	

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i punonjësve në bashki gjatë vitit të raportimit	341.00	310.00	Numër
Numri i punonjësve të larguar nga bashkia gjatë vitit të raportimit	31.00	43.00	Numër
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	28481.00	27195.00	Numër
Numri i punonjësve të trajnuar gjatë vitit	9.00	29.00	Numër
Numri i punonjësve të shërbimeve të nënkontraktuara në bashki gjatë vitit të raportimit	0.00	0.00	Numër



TRANSPARENCA

Përshkrim i përgjithshëm: Transparenca është një nga funksionet themelore të vetëqeverisjes vendore të parashikuara në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si parim që garanton ushtrimin demokratik dhe të përgjegjshëm të kompetencave të bashkisë. Ky ligj detyron njësitë e vetëqeverisjes vendore të veprojnë në mënyrë të hapur dhe të aksesueshme për publikun, duke siguruar informim të vazhdueshëm mbi vendimmarrjen, programet zhvillimore, menaxhimin financiar, prokurimet publike dhe shërbimet që ofrohen. Përmes transparencës, bashkia realizon parimin e llogaridhënies publike, nxit pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimmarrëse dhe forcon besimin e publikut në administratën vendore. Zbatimi i këtij funksioni operohet në përputhje edhe me Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si instrumente ligjore plotësuese që konkretizojnë transparencën si standard të domosdoshëm të qeverisjes vendore

Në këtë seksion janë monitoruar 3 tregues kryesorë të cilët paraqiten me progres. Bashkia ka vazhduar të zbatojë procedurën e konsultimit publik për të gjitha aktet e detyrueshme. Në vitin 2023, numri i akteve për të cilat ishte i detyrueshëm konsultimi publik ishte 3, dhe për të gjitha këto aktet u zhvillua konsultim publik. Gjatë vitit 2024, ky numër është dyfishuar në 6 akte, dhe për të gjashtat janë zhvilluar konsultime publike, duke treguar përparim në përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Megjithatë, Bashkia ende nuk ka hartuar Planin e Integritetit, një instrument i rëndësishëm për parandalimin e konfliktit të interesit dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë së

administratës. Hartimi dhe miratimi i këtij plani rekomandohet si prioritet për të garantuar që proceset e vendimmarrjes të jenë jo vetëm transparente, por edhe të mbrojtura nga risku i korrupsionit dhe ndikimeve të paqarta. Gjithashtu rezulton se Bashkia nuk ka publikuar as Raportin Vjetor të Transparencës për të dy vitet e monitoruara.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Akte për të cilët është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes	Po=1 Jo=0	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	
Tregues	Plani Vendor i Integritetit	Po=1 Jo=0	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i akteve gjithsej për të cilat është i detyrueshëm zhvillimi i konsultimit publik	3.00	6.00	Numër
Numri i akteve për të cilët është zhvilluar konsultimi publik	3.00	6.00	Numër
Publikimi i raportit vjetor për transparencën	0.00	0.00	Po=1/Jo=0
Plani Vendor i Integritetit, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Po=1/Jo=0



BARAZIA GJINORE

Përshkrim i përgjithshëm: Barazia gjinore në qeverisjen vendore është një element kyç për ndërtimin e institucioneve demokratike, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo nënkupton jo vetëm balancën në përfaqësim midis grave dhe burrave në pozicione drejtuese, por edhe integrimin sistematik të perspektivës gjinore në të gjitha proceset vendimmarrëse, politikat publike dhe ofrimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkitë duhet të garantojnë:

- pjesëmarrje të barabartë gjinore në strukturat vendimmarrëse dhe administrative;

- buxhetim të përgjigjshëm gjinor (gender-responsive budgeting), sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi;
- ofrim shërbimesh që adresojnë në mënyrë të barabartë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, në të gjithë diversitetin e tyre;
- mekanizma për mbrojtjen nga diskriminimi gjinor, diskriminimi për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (intersectional discrimination) dhe dhuna me bazë gjinore. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë jo vetëm për përfaqësimin gjinor në pozicione kyçe, por edhe për masat e marra për të zbatuar barazinë gjinore në praktikë, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare.

Gjatë periudhës së raportimit, përqindja e grave në pozicione kyçe politike dhe administrative (kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore) është përmirësuar nga 28.13% në 37.93%, një rritje prej 9.81 pikë përqindje , duke treguar një avancim pozitiv në përfshirjen e grave në vendimmarrje. Ky është një tregues i rëndësishëm i rritjes së përfaqësimit gjinor në nivelet më të larta të administratës dhe politikës lokale.

Ndërsa, përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme brenda bashkisë (të lartë, të mesme, të ulët) ka pësuar një rënie nga 55.56% në 41.67%, duke shënuar një ulje prej 25%, që tregon një përkeqësim të përfaqësimit gjinor në nivelet menaxheriale të administratës. Gjithashtu, Plan i Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore nuk është hartuar ende, duke mbetur në 0, që do të thotë se nuk ka një strategji të formalizuar për të adresuar çështjet e barazisë gjinore në institucion.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Përqindja e grave në pozicione: kryetare, zv/kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore	%	28.13	37.93	9.81	↑	Përmirësuar	●	35%
Tregues	Përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët) në bashki	%	55.56	41.67	-13.89	↓	Përkeqësuar	●	-25%
Tregues	Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore	Po=1 / Jo=0	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri gjithsej i pozicioneve drejtuese në bashki (Kryetare/Kryetar Bashkie, zv.Kryetare/zv.Kryetar Bashkie, Administratore/Administrator, Anëtare/Anëtarë në Këshill Bashkiak).	32.00	29.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese në bashki: Kryetare, zv.Kryetare, Anëtare në Këshill Bashkiak dhe Administratore	9.00	11.00	Numër
Numri i pozicioneve drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	9.00	12.00	Numër
Numri i grave në pozicione drejtuese të ndryshme (të lartë, të mesme, të ulët)	5.00	5.00	Numër
Plan Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore, i miratuar ose zbatuar gjatë periudhës së raportimit	0.00	0.00	Po=1/Jo=0

EU INTEGRIMI NË BE

Përshkrim i përgjithshëm: Integrimi në Bashkimin Evropian nuk është vetëm një detyrë e qeverisjes qendrore, por një proces i përbashkët që përfshin të gjitha nivelet e administratës publike, përfshirë pushtetin vendor. Bashkitë luajnë një rol kritik në afërsimin me *acquis communautaire* dhe përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, përmes politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Në këtë kuptim, bashkive u rekomandohet të:

- Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik • Ndërtojnë kapacitete administrative për të përthithur dhe zbatuar fondet e BE-së;
- Zhvillojnë plane vendore për përputhshmëri me politikat e BE-së në fusha si mjedisi, energjia, digjitalizimi, barazia gjinore, migracioni, zhvillimi rural dhe përfshirja sociale;
- Fuqizojnë rolin e komuniteteve në procesin e integrimit përmes transparencës, pjesëmarrjes dhe ndërtimit të besimit publik.

Gjatë periudhës 2023–2024, bashkia ka ruajtur stabilitetin në disa tregues kyç. Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara ka mbetur 3 për të dy vitet si dhe krijimi dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki tregon për një konsolidim të strukturave përgjegjëse për performancën. Nga ana tjetër Bashkia ka hartuar dhe është duke zbatuar planet e migracionit dhe diasporës.

Vihet re nga të dhënat se komisionet e integrimit evropian pranë këshillave bashkiakë nuk janë krijuar ende dhe sinjalizon për më shumë vullnet insitucional. Një problem i rëndësishëm vihet re në projektet e

aplikuara kundrejt atyre të fituara dhe financuara nga Bashkimi European: përqindja e projekteve të fituara ka rënë nga 100% në 40%, një përkeqësim prej 60%, por duke qenë se për vitin 2023 janë raportuar si aplikime vetëm numri i projekteve fituese rezultojnë këta tregues.

Gjithashtu kjo tregon se bashkia ka pasur vështirësi në sigurimin e financimeve europiane për projektet e propozuara, duke treguar nevojën për forcim të kapaciteteve të strukturave të menaxhimit të projekteve dhe të praktikave të aplikimit për fonde ndërkombëtare.

A) Lista e Detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki	Numër	3.00	3.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Ekzistenca dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki	Po=1 / Jo=0	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Projekte të fituara kundrejt të aplikuar nga bashkimi evropian (periudha 2-vjeçare 2023-2024)	%	100.00	40.00	-60.00	↓	Përkeqësuar	●	-60%
Tregues	Planet e migracionit dhe diasporës	Po=1 / Jo=0	1.00	1.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	0%
Tregues	Komisionet e integritetit evropian pranë këshillave bashkiakë	Po=1 / Jo=0	0.00	0.00	0.00	→	Pa ndryshim	●	

B) Të dhënat

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara	3.00	3.00	Numër
Struktura e performancës e përfshirë në organizimin funksional të bashkisë	1.00	1.00	Po=1/Jo=0
Strukturat e performancës ngritur pranë drejtorisë së Integritetit Evropian sipas manualeve orientuese të AMVV-së	1.00	1.00	Po=1/Jo=0
Numri i projekteve të BE që bashkia ka aplikuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	5.00	Numër
Numri i projekteve të BE të fituara gjatë periudhës së raportimit	1.00	2.00	Numër
Plani Vendor i Migracionit dhe Diasporës, i miratuar apo zbatuar gjatë periudhës së raportimit	1.00	1.00	Po=1/Jo=0
Komisionet e Integritetit Evropian pranë Këshillave Bashkiakë	0.00	0.00	Po=1/Jo=0

MENAXHIMI FINANCIAR

Përshkrimi i përgjithshëm: Menaxhimi financiar është një funksion kyç për sigurimin e qëndrueshmërisë dhe eficiencës së qeverisjes vendore. Ai përfshin planifikimin, administrimin dhe raportimin e burimeve financiare të bashkisë, në përputhje me parimet e përgjegjshmërisë dhe transparencës. Në përmbushjen e këtij funksioni, bashkitë udhëhiqen nga kuadri ligjor për financat vendore, përfshirë Ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Kjo kategori ndahet në tre fusha të veçanta që mbulojnë ciklin financiar: të ardhurat, shpenzimet, dhe buxhetimi. Vlerësimi i këtyre fushave ndihmon në monitorimin e kapaciteteve financiare të bashkive dhe në analizimin e performancës së tyre në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve publike.

Gjatë periudhës së raportimit, të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga 4,974.72 në 5,947.01 lekë/person (+20%), duke treguar përmirësim në mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Shkalla e përdorimit të të ardhurave ka shënuar një rënie drastike nga 829.60 % në 76.19%. Të dhënat tregojnë përdorim më pak të efektshëm dhe potencialisht ulje të kapaciteteve për shpenzime të planifikuara. Të ardhurat nga taksa e pasurisë gjithashtu kanë shënuar ulje modeste, nga 28.96% në 28.95% (-0.01%), duke ruajtur një kontribut të qëndrueshëm ndaj buxhetit vendor.

Nga ana tjetër, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit ka rënë nga 125.84% në 13.27% (-112.57%), ndërsa buxheti i miratuar për frymë ka shënuar një rritje të lehtë nga 32,796.50 në 34,155.40 lekë/person (+4%). Ulja e konsiderueshme e të ardhurave të veta ndaj buxhetit tregon një dobësim të raportit të vetë-mjaftueshmërisë së bashkisë dhe potencialisht një varësi më të madhe nga transfertat qendrore. Investimet për frymë janë rritur ndjeshëm nga 6,605.84 në 9,519.40 lekë/person (+44%), duke përmirësuar peshën e investimeve në buxhet nga 20.14% në 27.87% (+38%), duke treguar prioritet në zhvillim dhe përmirësim të infrastrukturës. Megjithatë, pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve ka shënuar një rritje të lehtë nga 16.74% në 17.33% (+4%), që tregon nevojën për menaxhim më të kujdesshëm të borxheve.

A) Lista e detajuar

Lloj	Emri	Njësia Matëse	Vlera 2023	Vlera 2024	Trendi	Simboli i trendit	Kategoria e trendit	Semafor	% Ndryshimi
Tregues	Të ardhurat e veta për frymë	Leke /person	4974.72	5947.01	972.29	↑	Përmirësuar	●	20%
Tregues	Të ardhurat e veta përkundrejt transfertave	%	13.05	18.19	5.14	↑	Përmirësuar	●	39%
Tregues	Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit	%	125.84	13.27	-112.57	↓	Përkeqësuar	●	-89%
Tregues	Shkalla e përdorimit të të ardhurave	%	829.60	76.19	-753.41	↓	Përkeqësuar	●	-91%
Tregues	Të ardhurat nga taksa e pasurisë ne raport me të ardhurat vendore	%	28.96	28.95	-0.01	↓	Përkeqësuar	●	-0.03%
Tregues	Buxheti i miratuar për frymë	Leke /person	32796.50	34155.40	1358.90	↑	Përmirësuar	●	4%
Tregues	Shkalla e ekzekutimit të buxhetit	%	100.00	100.00	0.00	→	Pa ndryshim		0%
Tregues	Investime për frymë	Leke /person	6605.84	9519.40	2913.55	↑	Përmirësuar	●	44%
Tregues	Pesha e investimeve në buxhet	%	20.14	27.87	7.73	↑	Përmirësuar	●	38%
Tregues	Pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve	%	16.74	17.33	0.59	↑	Përkeqësuar	●	4%
Tregues	Pesha e personelit në buxhet	%	23.98	28.47	4.49	↑	Përmirësuar	●	19%
Tregues	Pesha e shpenzimeve operacionale në buxhet	%	15.56	16.36	0.80	↑	Përmirësuar	●	5%

B) Të dhënat burim

E dhëna	Vlera 2023	Vlera 2024	Njësia Matëse
Të ardhurat e veta, fakt	141685.00	161729.00	Mijë Leke
Popullsia e përgjithshme e bashkisë	28481.00	27195.00	Numër
Transferrat gjithsej, fakt	1085530.60	889192.90	Mijë Leke
Të ardhurat e përgjithshme, fakt	112594.00	1219204.00	Mijë Leke
Totalit i shpenzimeve të bashkisë, fakt	934077.00	928856.00	Mijë Leke
Të ardhurat nga taksa e pasurisë, fakt	41038.00	46820.60	Mijë Leke
Shpenzime gjithsej, plan i rishikuar	934077.00	928856.00	Mijë Leke
Shpenzime kapitale, fakt	188141.00	258880.00	Mijë Leke
Detyrime të papaguara mbi 30 ditë	156402.00	161007.00	Mijë Leke
Shpenzime personeli, fakt	223978.70	264399.50	Mijë Leke
Shpenzime operacionale, fakt	145363.50	151955.90	Mijë Leke



TË ARDHURAT

Kjo fushë vlerëson kapacitetin e bashkisë për të gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe diversifikuara përmes burimeve të veta dhe atyre të transferuara. Analiza e të ardhurave kontribuon në kuptimin e varësisë nga transfertat qendrore dhe fuqisë fiskale lokale. E drejta e njësive të vetëqeverisjes vendore për të mbledhur të ardhura buron nga neni 11 i Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i cili përcakton burimet e të ardhurave që administrohen nga bashkitë.

Gjatë periudhës së raportimit, të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga 4,974.72 në 5,947.01 lekë/person (+20%), duke treguar përmirësim në mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Të ardhurat nga taksa e pasurisë kanë shënuar një rënie të lehtë nga 28.96% në 28.95%, duke ruajtur një kontribut të qëndrueshëm ndaj buxhetit vendor. Megjithatë, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit ka rënë ndjeshëm nga 125.84% në 13.27% (-89%), duke treguar një ulje të vetë-mjaftueshmërisë së bashkisë dhe një varësi më të madhe nga transfertat qendrore. Kjo situatë kërkon përmirësim në mobilizimin e të ardhurave të veta dhe strategji më efektive për rritjen e pavarësisë financiare të bashkisë.



BUXHETI

Fusha e buxhetit fokusohet në procesin e hartimit, miratimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor bashkiak, si dhe përputhshmërinë me ciklin buxhetor. Procesi i planifikimit dhe miratimit të buxhetit lokal rregullohet nga neni 21-25 i Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" si dhe nga udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave.

Buxheti i miratuar për frymë ka shënuar një rritje nga 32,796.50 në 34,155.40 lekë/person (+4%) dhe shkalla e ekzekutimit të buxhetit ka mbetur 100%, duke treguar se buxheti është shfrytëzuar plotësisht sipas planit.



SHPENZIMET

Kjo fushë analizon strukturën dhe efikasitetin e shpenzimeve publike të bashkive për të përmbushur funksionet e tyre ligjore. Ajo vlerëson nëse fondet shpenzohen në mënyrë të efektshme dhe transparente. Bashkitë janë përgjegjëse për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve publike vendore, në përputhje me nenin 12 dhe 13 të Ligjit nr. 68/2017 dhe aktet nënligjore përkatëse

Shpenzimet kapitale kanë pasur një përmirësim të dukshëm, me investimet për frymë që janë rritur nga 6,605.84 në 9,519.40 lekë/person (+44%), duke rritur edhe peshën e investimeve në buxhet nga 20.14% në 27.87% (+38%). Kjo tregon orientim më të fortë drejt projekteve zhvillimore dhe infrastrukturës. Megjithatë, detyrimet financiare të papaguara kanë shënuar rritje të lehtë nga 16.74% në 17.33% (+4%), duke sinjalizuar nevojën për kujdes në menaxhimin e likuiditetit dhe shmangien e akumulimit të borxheve ndaj palëve të treta.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përgjithësi, bashkia ka bërë përparime në disa fusha, por ka nevojë për angazhim të vazhdueshëm për të adresuar sfidat që mbeten.

1. ARSIMI

Përfundime:

Në përgjithësi, vitin 2024 e karakterizon një trend pozitiv në arsimin parauniversitar. Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike u rrit nga 18.33% në 21.67%, ndërsa në kopshte publike arriti 88.5%, duke reflektuar rritje të aksesit në institucionet edukative me 18% përsa i përket çerdheve dhe me 6% përsa i përket kopshteve. Numri i godinave arsimore sipas nivelit arsimor për të dy vitet vijon të qendrojë i njëjtë duke treguar mungesë të investimeve në infrastrukturën arsimore.

Nga ana tjetër ka edhe një përkeqësim të raportit fëmijë–mësues nga 10.81 në 11.42 që është një tregues i uljes së cilësisë së kujdesit për këtë shërim ndaj fëmijëve. Bashkia duhet të marrë masa që të monitorojë këtë raport dhe të adresojë cdo problematikë, pasi me shtimin e numrit të fëmijëve që

regjistrohen në çerdhe dhe kopshte duhet të shtohet edhe numri i edukatorëve për të siguruar shërbim cilësor në këto institucione. Element pozitiv është zbatimi i Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar

Rekomandime:

1. Rritja e numrit të edukatorëve. Për të garantuar një përmirësim të qëndrueshëm në cilësinë dhe aksesueshmërinë e arsimit parauniversitar, rekomandohet që bashkia të ndërmarrë masa të qarta për rritjen e numrit të edukatorëve në çerdhe dhe kopshte, me qëllim përmirësimin e raportit fëmijë-mësues. Ky hap është thelbësor për sigurimin e standardeve të kujdesit dhe zhvillimit të fëmijëve në institucionet arsimore të hershme.

2. Investime në infrastrukturën arsimore. Gjithashtu, kërkohet hartimi dhe zbatimi i një plani investimesh në infrastrukturën arsimore, pasi numri i pandryshuar i godinave sugjeron kufizime në kapacitetet ekzistuese. Investimet duhet të synojnë zgjerimin, rehabilitimin dhe modernizimin e ambienteve për të përballuar rritjen e kërkesës dhe për të ofruar kushte më cilësore.

3. Monitorim i vazhdueshëm i treguesve të aksesit dhe cilësisë. Rekomandohet gjithashtu vendosja e një mekanizmi të qëndrueshëm për monitorimin periodik të treguesve të performancës në arsim, si niveli i regjistrimit, kapacitetet e ngarkuara të institucioneve dhe shpërndarja e stafit edukativ. Këto të dhëna do të mundësojnë ndërhyrje të shpejta dhe të bazuara në evidencë.

4. Rritja e kapacitetit profesional të edukatorëve. Të investohet në trajnime të posaçme për edukatorët, duke synuar rritjen e cilësisë së shërbimit dhe adoptimin e metodologjive bashkëkohore të edukimit në moshë të hershme. Paralelisht, bashkia duhet të përforcojë kapacitetet profesionale të edukatorëve përmes programeve të vazhdueshme të trajnimit dhe zhvillimit, duke synuar përmirësimin e praktikave pedagogjike dhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

5. Hartimi i një strategjie afatgjatë për arsimin e hershëm. Së fundi, rekomandohet hartimi i një strategjie afatgjatë për zhvillimin e arsimit në moshë të hershme, e cila të adresojë planifikimin e burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme për përmbushjen e nevojave të komunitetit në vitet në vijim.

2. MENAXHIMI I MBETJEVE

Përfundime:

Të dhënat tregojnë një situatë të ndërlikuar në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Mbulimi i popullsisë me shërbim në nivel të përgjithshëm ka mbetur i pandryshuar (80.2%), ndërsa zona urbane kanë një mbulim 100% të qëndrueshëm, zonat rurale vijon të mbetet në nivel të ulët të mbulimit me këtë shërbim dhe pa bërë progres (60.53%).

Sasia e mbetjeve të gjeneruara për banor ka pësuar një rënie prej -52%. Kjo ulje shumë e madhe interpretohet nga Bashkia si efekt i ndryshimeve në metodologjinë e matjes. Gjatë 2023 është përdorur një metodë vlerësimi e sasisë së mbetjeve ndërsa gjatë 2024 është përdorur peshimi i sasisë së mbetjeve. Gjithashtu mbulimi i kostove të menaxhimit të mbetjeve ka rënë me 43%, duke treguar dobësim të qëndrueshmërisë financiare të sistemit dhe rritje të varësisë nga transfertat. Situata institucionale dhe strategjike është përmirësuar pas miratimit të planit vendor të menaxhimit të mbetjeve, i cili synon një mbulim më të gjërë të shërbimit në zonat urbane dhe rurale, si edhe një shpërndarje më eficiente të burimeve financiare dhe njerëzore për të përmirësuar këtë shërbim.

Rekomandime:

1. Rishikimi i metodologjisë së matjes dhe raportimit të mbetjeve. Rënia e menjëhershme dhe e pazakontë prej -55% në sasinë e mbetjeve të gjeneruara për banor tregon nevojën për një rishikim të thelluar të metodologjisë së mbledhjes dhe raportimit të të dhënave. Bashkia duhet të verifikojnë burimet e informacionit, mënyrën e raportimit nga operatorët, pajisjet matëse, proceset e peshimit dhe regjistrimit, si dhe ndryshimet eventuale në mbulimin territorial. Vetëm pasi të sigurohet se të dhënat janë të sakta dhe të krahasueshme me vitet e mëparshme, mund të përgatiten politika të sakta planifikimi dhe ndërhyrjeje në sektor.

2. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Rënia e mbulimit të kostove nga tarifa e shërbimit nga 46.76% në 26.46% tregon dobësim të ndjeshëm të qëndrueshmërisë financiare të sistemit. Për këtë arsye, është e nevojshme të kryhet një analizë e plotë financiare që identifikon hendekun midis kostove operative dhe të ardhurave të siguruara nga tarifa, duke marrë parasysh edhe përballueshmërinë e familjeve. Bazuar në këtë analizë, duhet rishikuar struktura e tarifës, rritur efikasiteti i operatorëve dhe zbutur kostot operative përmes optimizimit të linjave të kolektimit dhe menaxhimit. Vetëm përmes një modeli financiar të qëndrueshëm, shërbimi mund të ofrojë cilësi dhe mbulim të mjaftueshëm.

3. Rritja e mbulimit të popullsisë në zonat rurale. Edhe pse treguesi ka mbetur i pandryshuar, mbulimi i ulët në zonat rurale (60.53%) tregon se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë vijon të mos ketë akses të rregullt në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Për përmirësim, rekomandohet krijimi i modeleve të përshtatura për zonat rurale - si pika grupimi të përbashkëta, frekuenca më fleksibile e mbledhjes, përfshirja e operatorëve të vegjël lokalë ose subvencionimi i kostove të shërbimit. Ndërhyrje të tilla duhet të kombinohen me sensibilizim komunitar dhe koordinim me njësitë administrative, duke synuar rritje graduale të mbulimit dhe ulje të ndotjes mjedisore.

4. Rritja e mbulimit të përgjithshëm të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Mbulimi total prej vetëm 42.76% në nivel bashkie sugjerojnë nevojën për një plan të qartë zgjerimi të shërbimit, i cili duhet të fillojë me identifikimin e zonave të pambuluara dhe analizimin e arsyeve të mos-përfshirjes së tyre në shërbim. Pasi të hartohet një hartë e detajuar e këtyre zonave, bashkia duhet të përcaktojë objektiva vjetore zgjerimi për të siguruar që mbulimi të rritet gradualisht, duke përfshirë edhe zonat periferike me infrastrukturë të dobët. Ky zgjerim kërkon koordinim ndërmjet operatorëve, strukturave financiare dhe

sektorëve urbanistikë, për të garantuar një shërbim funksional, të aksesueshëm dhe të standardizuar për të gjithë popullsinë.

3. MBROJTJA NGA ZJARRI

Përfundime:

Për vitin 2024 ky shërbim paraqet me përmirësim përse i përket numrit të punonjësve i cili është rritur më 27% që mund të ketë ardhur si rezultat i riorganizimit të burimeve njerëzore të mbrojtjes nga zjarri. Përse i përket flotës së automjeteve për të nëjtin vit ka një përgjysmim të numrit të mjeteve zjarrfikëse për popullsi, pasi një prej automjeteve është transferuar për përdorim tek një institucion tjetër (Burgu Rogozhinë).

Në terma të menaxhimit të riskut dhe kapaciteteve të emergjencës, treguesi i automjeteve ka peshë më të madhe direkte mbi aftësinë për të menaxhuar zjarrin. Për këtë arsye, pavarësisht përmirësimit të stafit, rënia e flotës e mbingarkon shërbimin dhe ul nivelin e sigurisë publike.

Rekomandime:

1. Rritje e investimeve në flotën e automjeteve zjarrfikëse. Është e domosdoshme të planifikohet një rritje e qëndrueshme e investimeve në flotën e automjeteve zjarrfikëse, duke u fokusuar si në blerjen e mjeteve të reja që përmbushin standardet bashkëkohore, ashtu edhe në modernizimin e mjeteve ekzistuese përmes riparimeve kapitale dhe pajisjeve shtesë. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet zëvendësimit të mjeteve të amortizuara përpara se të dalin plotësisht jashtë funksioni, në mënyrë që shërbimi të mos mbetet pa kapacitete operacionale në periudha kritike. Rritja e investimeve është hapi themelor për rikthimin e një niveli të mjaftueshëm të sigurisë dhe reagimit ndaj emergjencave.

2. Kombinimi i treguesve dhe analizë e raportit zjarrfikës/automjet. Rekomandohet hartimi i një analize të balancës midis numrit të zjarrfikësve dhe mjeteve zjarrfikëse, me qëllim vlerësimin e kapaciteteve reale operacionale të shërbimit. Ky raport do të ndihmojë në identifikimin e mospërputhjeve, si situatat kur ka staf të mjaftueshëm, por mungojnë mjetet për t'i angazhuar në terren, ose raste kur ekzistojnë automjete por mungon personeli i specializuar për t'i përdorur ato. Rezultatet e kësaj analize do të mundësojnë një planifikim më të mirë të investimeve dhe një shpërndarje më efikase të burimeve njerëzore dhe teknike.

3. Planifikim i investimeve dhe Harmonizimi i rekrutimeve me zgjerimin e flotës. Proceset e rekrutimit duhet të përafrohen me zgjerimin dhe përditësimin e flotës së mjeteve zjarrfikëse, në mënyrë që stafi i ri të ketë kapacitet real për të operuar në terren. Kjo nënkupton planifikim të integruar të burimeve njerëzore dhe teknike, duke siguruar që çdo rritje e numrit të zjarrfikësve të shoqërohet me mjete funksionale, pajisje adekuate dhe trajnime të specializuara. Një qasje e tillë shmang situatat ku rritet numri i stafit, por kapaciteti real operacional mbetet i kufizuar, duke garantuar kështu që investimet të përkthehen në rritje të vërtetë të efektivitetit dhe sigurisë.

4. MENAXHIMI I INFRASTRUKTURES SE UJITJES DHE KULLIMIT

Përfundime:

Sipërfaqja totale e tokës bujqësore në bashki ka mbetur e pandryshuar (13,180 ha), po ashtu edhe sipërfaqja e mbuluar me kanale ujitje dhe/ose kullimi jon të mbetet e njëjtë. Gjatësia totale e kanaleve ujitëse dhe ujëtëse funksionale ka një rënie të lehtë. Ndryshimi është i vogël (~1 km) dhe tregon një jo përkeqësim serioz në infrastrukturën e ujitjes.

Gjatësia e kanaleve kulluese ka rënë në mënyrë drastike me — nga 247.60 km në vetëm 83 km. Po aq e madhe është rënia edhe për kanalet kulluese funksionale. Kjo përfaqëson një ulje prej rreth 66% të infrastrukturës së kullimit, duke krijuar një risk shumë të lartë për përmytje të tokave bujqësore, rënie të prodhimit dhe cilësisë së tokës, dëmtime të kulturave bujqësore në periudha reshesh intensive, etj. Kjo ulje masive është tregues i një problemi serioz në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e rrjetit të drenazhimit.

Rekomandime:

1. Përmirësimi i mbulimit të tokës bujqësore me sisteme ujitjeje dhe kullimi. Rekomandohet që bashkia të hartojë një plan të posaçëm investimesh dhe mirëmbajtjeje për të rikthyer mbulimin e plotë të sipërfaqes së tokës bujqësore me rrjet ujitjeje dhe kullimi. Duhet të kryhet një verifikim në terren për të identifikuar segmentet e dëmtuara, të bllokuara ose të abandonuara të rrjetit, dhe të krijohet një listë prioritetesh bazuar në zonat me prodhimtari më të lartë ose risk më të madh përmytjesh. Bashkia mund të synojë financim nga IPARD, fondet kombëtare ose partneritete me përdoruesit e tokës për t'i rikthyer gradualisht këto sipërfaqe në funksion.

2. Forcimi i infrastrukturës së ujitjes. Edhe pse rrjeti i ujitjes ka pësuar pak ndryshime, rekomandohet rritja e kapaciteteve të mirëmbajtjes për të shmangur degradimin gradual dhe për të përmirësuar kapacitetin për periudha të thata. Bashkia duhet të kryejë monitorim sezonal të kanaleve ujitëse dhe të investojë në pastrimin teknik, rehabilitimin e pikatve kritike dhe automatizimin e disa segmenteve, ku është e mundur. Përfshirja e shoqatave të përdoruesve të ujit mund të përmirësojë ndjeshëm menaxhimin dhe qëndrueshmërinë e rrjetit.

3. Rehabilitimi urgjent i kanaleve kulluese. Duke qenë se kanalet kulluese kanë rënë me mbi 60%, rekomandohet ndërhyrje urgjente për rehabilitimin e tyre si një masë mbrojtëse për prodhimin bujqësor dhe për reduktimin e riskut të përmytjeve. Bashkia duhet të nisë një projekt të ri inventarizimi dhe vlerësimi teknik për të identifikuar arsyet e humbjes së gjatësisë së rrjetit dhe për të përcaktuar zonat ku ndërhyrja është më urgjente. Investimi në rikonstrukcion, pastrim dhe zgjerim të rrjetit të kullimit është kritik, pasi ndikimi i mungesës së tij është i menjëhershëm dhe shumë i madh në cilësinë e tokës.

4. Përmirësimi i menaxhimit dhe monitorimit të infrastrukturës bujqësore. Rekomandohet vendosja e një sistemi periodik monitorimi teknik dhe raportimi transparent për gjithë rrjetin e ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë matje fizike, inspektime në terren dhe raportim vjetor publik. Kjo do të shmangë mospërputhjet në të dhëna, do të ndihmojë në planifikim realist të investimeve dhe do të rrisë efikasitetin e përdorimit të fondeve publike. Përfshirja e fermerëve në proceset e konsultimit dhe feedback-ut mund të sigurojë informacione të sakta dhe të shpejta për zonat me problematika.

5. ADMINISTRIMI PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përfundime:

Të dhënat tregojnë se bashkia nuk ka asnjë plan mbarështimi të miratuar ose të zbatuar për fondin pyjor dhe kullosor (vlera 0 për të dy vitet). Kjo është një mangësi kritike, pasi planet e mbarështimit janë dokumentet bazë që përcaktojnë mënyrën e administrimit, planifikimit të prerjeve, ripyllëzimeve, kullotjes, masave mbrojtëse dhe të gjitha ndërhyrjeve në territor. Mungesa e një plani do të thotë se menaxhimi kryhet pa orientim teknik dhe pa dokumentacion të domosdoshëm ligjor.

Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor, nuk ka ndryshime por është përmirësuar raporti punonjës për 1000 ha duke shënuar një rritje me 35%. Gjithashtu edhe numri i punonjësve është rritur nga 3 në 4, por ky staf mbetet shumë i pamjaftueshëm për të administruar një sipërfaqe të konsiderueshme, edhe nëse merret si referencë vlera e re më e ulët. Edhe në rastin më të mirë, treguesit sugjerojnë një administrim minimalist, më tepër formal sesa funksional.

Rekomandime:

1. Hartimi dhe miratimi i planit vendor të mbarështimit. Është e domosdoshme që bashkia të hartojë menjëherë një plan vendor të mbarështimit për fondin pyjor dhe kullosor, i cili të përfshijë të gjitha masat për administrimin, përdorimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave. Ky plan duhet të jetë në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe praktikën më të mirë mjedisore, duke përfshirë përcaktimin e zonave për prerje të kontrolluara, ripyllëzim, kullotje të menaxhuar dhe masat mbrojtëse për biodiversitetin dhe tokën. Miratimi i planit do të krijojë bazën ligjore dhe teknike për çdo ndërhyrje në fondin pyjor dhe kullosor.

2. Verifikimi dhe riklasifikimi i sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor. Rënia drastike e sipërfaqes së raportuar nga 20,936 ha në 3,135 ha tregon nevojën për një auditim të menjëhershëm të të dhënave. Bashkia duhet të kryejë inventarizim fizik dhe teknik të pyjeve dhe kullotave për të konfirmuar sipërfaqet reale dhe për të korrigjuar të dhënat në mënyrë që të pasqyrojnë gjendjen faktike. Kjo do të sigurojë që planet e menaxhimit të bazohen mbi informacion të saktë dhe të shmangë humbjet e mundshme të resurseve natyrore.

3. Rritja e kapaciteteve njerëzore për menaxhimin e fondit. Numri aktual i punonjësve (4 persona) është shumë i ulët për të administruar fondin pyjor dhe kullosor në mënyrë efektive. Bashkia duhet të

planifikojë rritjen e stafit teknik dhe të menaxhimit, duke përfshirë specialistë për pylltari, ekologji dhe kullotje, si dhe të sigurojë trajnime të rregullta. Një staf i mjaftueshëm dhe i kualifikuar është i domosdoshëm për zbatimin e planeve, monitorimin e gjendjes së sipërfaqeve dhe garantimin e përdorimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore.

4. Vendosja e sistemit të monitorimit dhe raportimit të rregullt. Për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të fondit pyjor dhe kullosor, rekomandohet krijimi i një sistemi të monitorimit teknik dhe raportimit të rregullt. Ky sistem duhet të përfshijë inspektime periodike, regjistrim të ndërhyrjeve, gjendjes së pyjeve dhe kullotave, si dhe raporte vjetore për statusin e resurseve. Përfshirja e teknologjive GIS dhe të dronëve mund të ndihmojë në mbikëqyrje më efikase dhe identifikimin e problematikave në kohë reale.

6. MBROJTJA SOCIALE

Përfundime:

Ndihma ekonomike për familjet ka shënuar një rritje të moderuar të aplikimeve (nga 214 në 240) dhe të përfituesve (nga 214 në 229), duke treguar një përgjigje pozitive të bashkisë. Megjithatë, ekziston një hendek i vogël midis aplikimeve dhe përfituesve, që tregon nevojën për rishikim të kriterëve ose kapaciteteve financiare.

Programet e strehimit social kanë shënuar një rënie të aplikimeve (nga 43 në 25), ndërsa të gjithë aplikantët e vitit 2024 kanë përfituar shërbime. Mungesa e të dhënave për vitin 2023 e vështirëson krahasimin, por treguesi aktual tregon efikasitet në shpërndarje.

Shërbimet e tjera sociale kanë probleme të dukshme: mungojnë të dhëna për vitin 2023, numri i rasteve të dhunës të referuara në 2024 është 9, por vetëm një rast ka përfituar mbështetje; nga 29 persona PAK të referuar, vetëm 14 kanë marrë shërbime. Mungesa e qendrave sociale ditore dhe rezidenciale (0 funksionale) kufizon ndjeshëm mundësitë për ofrimin e shërbimeve për grupet vulnerabël.

Plani Vendor Social i hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2024 tregon progres institucional, por sfida mbetet zbatimi dhe monitorimi, sidomos kur ka vështirësi institucionale për mbledhjen e informacionit.

Për këtë shërbim Bashkia ka një mungesë të madhe të të dhënave për vitin 2023 dhe përlllogaritjet nuk mund të kryhen për të evidentuar zhvillimet gjatë 2023-2024 (semafori gri në tabelat më poshtë). Vihet re nevoja që Bashkia të rrisë më tej kapacitetet institucionale për mbledhjen, administrimin dhe raportimin e të dhënave, me qëllim sigurimin e informacionit të plotë dhe të besueshëm në proceset e raportimit, dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna.

Rekomandime:

1. Përmirësimi i shpërndarjes së ndihmës ekonomike. Rishikimi i kriterëve dhe rritja e kapaciteteve financiare do të sigurojnë që të gjitha familjet që plotësojnë kushtet të përfitojnë ndihmën. Vendorsja e një sistemi monitorimi do të lehtësojë ndjekjen e përfituesve dhe identifikimin e nevojave emergjente.

2. Forcimi i aksesit në strehimin social. Për të rritur mbulimin dhe për të shmangur mos-shfrytëzimin e shërbimeve, rekomandohet informim më i mirë për qytetarët mbi mundësitë e strehimit dhe rritja e kapaciteteve për trajtimin e kërkesave.

3. Krijimi i qendrave sociale ditore. Bashkia duhet të rivendosë qendrat ditore ose të krijojë alternativa të përkohshme për ofrimin e shërbimeve ditore, duke u fokusuar tek fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta.

4. Përmirësimi i mbështetjes për viktimat e dhunës dhe PAK. Rritja e kapaciteteve të shërbimeve sociale, koordinimi i mekanizmave të referimit dhe përfshirja e trajnimeve për stafin do të sigurojë që të gjithë personat e prekur nga dhuna ose personat me aftësi të kufizuara të marrin mbështetje adekuate.

5. Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor Social. Vendorsja e një sistemi të rregullt monitorimi dhe raportimi do të ndihmojë në zbatimin efektiv të planit, duke shmangur boshllëqet që krijohen nga mungesa e të dhënave dhe duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

7. BURIMET NJERËZORE

Përfundime:

Gjatë periudhës së raportimit, numri i punonjësve të bashkisë ka rënë nga 341 në 310, ndërkohë që largimet janë rritur nga 31 në 43, duke reflektuar një trend të qartë të reduktimit të stafit. Kjo ka rritur shkallën e rotacionit të stafit nga 9.09% në 13.87%, që, nëse largimet kanë qenë vullnetare (pension, largim i dëshiruar), mund të sjellë përforcim të dinamikës së punës dhe qarkullim të ideve, por kërkon menaxhim të kujdesshëm për të mos destabilizuar proceset administrative. Raportin punonjës/1000 banorë gjithashtu ka pësuar një rënie të lehtë nga 11.97 në 11.40 punonjës për 1,000 banorë (-5%), duke rritur ngarkesën e punonjësve dhe potencialisht ndikimin mbi cilësinë e shërbimeve.

Nga perspektiva e menaxhimit të burimeve njerëzore, përpjekjet për zhvillim profesional kanë dhënë rezultate pozitive: përqindja e stafit të trajnuar është rritur nga 2.64% në 9.35% (+254%), duke rritur kapacitetin dhe efikasitetin e administratës. Gjithashtu, mungesa e stafit të nënkontraktuar (0 punonjës) tregon se të gjitha shërbimet janë ofruar nga stafi i brendshëm, gjë që ndihmon në kontrollin e cilësisë, por njëkohësisht vendos presion më të madh mbi stafin ekzistues. Menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore duhet të balancojë reduktimin e stafit me zhvillimin profesional dhe shpërndarjen adekuate të detyrave për të ruajtur cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandime:

1. Stabilizimi i stafit dhe reduktimi i largimeve. Duke marrë parasysh rënien e numrit të punonjësve nga 341 në 310 dhe rritjen e largimeve nga 31 në 43, rekomandohet hartimi i një plani strategjik për rekrutime të synuara dhe stabilizim të stafit. Ky plan duhet të fokusohet në zëvendësimin e punonjësve të larguar dhe në plotësimin e boshllëqeve në sektorët më të ngarkuar.

2. Përmirësimi i raportit punonjës/popullsi. Për shkak të reduktimit të stafit, rekomandohet vlerësimi i ngarkesës së punonjësve në secilin sektor dhe vendosja e burimeve shtesë aty ku është më e nevojshme. Kjo do të zvogëlojë mbingarkesën e stafit dhe do të rrisë cilësinë e shërbimeve për qytetarët.

3. Rritja dhe zgjerimi i trajnimeve. Përqindja e stafit të trajnuar ka shënuar rritje nga 2.64% në 9.35%, dhe numri i trajnuar ka shkuar nga 9 në 29 punonjës. Rekomandohet që programet e trajnimit të vazhdojnë dhe të zgjerojnë përfshirjen në të gjithë stafin, duke përfshirë trajnime për menaxhim, shërbime ndaj qytetarëve dhe aftësi teknike sipas sektorëve, për të rritur kapacitetin dhe efikasitetin e administratës.

4. Menaxhimi i rotacionit të stafit. Shkalla e rotacionit ka shënuar rritje në 13.87%. Rekomandohet të vendosen mekanizma për menaxhim të rotacionit, duke siguruar përcjellje të njohurive dhe stabilitet në proceset e brendshme, në mënyrë që qarkullimi i stafit të mos dëmtojë vazhdimësinë e shërbimeve.

5. Monitorimi dhe planifikimi afatgjatë. Për të siguruar që të gjithë treguesit e burimeve njerëzore përmirësohen vazhdimisht, rekomandohet vendosja e një sistemi të rregullt monitorimi dhe raportimi, që do të identifikojë boshllëqet, efektivitetin e trajnimeve dhe ndikimin e rotacionit, si dhe do të ndihmojë në planifikimin strategjik të stafit për vitet e ardhshme.

8. TRANSPARENCA

Përfundime:

Bashkia ka vazhduar të zbatojë procedurën e konsultimit publik për të gjitha aktet e detyrueshme. Në vitin 2023, numri i akteve për të cilat ishte i detyrueshëm konsultimi publik ishte 3, dhe për të gjitha këto aktet u zhvillua konsultim publik. Gjatë vitit 2024, ky numër është dyfishuar në 6 akte, dhe për të gjashtat janë zhvilluar konsultime publike, duke treguar përparim në përfshirjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Megjithatë, Bashkia ende nuk ka hartuar Planin e Integritetit, një instrument i rëndësishëm për parandalimin e konfliktit të interesit dhe përmirësimin e transparencës dhe besueshmërisë së administratës. Hartimi dhe miratimi i këtij plani rekomandohet si prioritet për të garantuar që proceset e vendimmarrjes të jenë jo vetëm transparente, por edhe të mbrojtura nga risku i korrupsionit dhe ndikimeve të paqarta.

Gjithashtu rezulton se Bashkia nuk ka publikuar as Raportin Vjetor te Transparences per te dy vitet e monitoruara.

Rekomandime:

1. Hartimi i Planit të Integritetit. Bashkia duhet të hartojë dhe miratojë menjëherë Planin e Integritetit, për të siguruar procedura të qarta për parandalimin e konfliktit të interesit, korrupsionit dhe abuzimeve në procesin e vendimmarrjes.

2. Zgjerimi i konsultimit publik. Edhe pse për të gjitha aktet e detyrueshme në 2023 dhe 2024 është zhvilluar konsultim publik, rekomandohet që ky proces të aplikohet edhe për aktet jo-obligative me ndikim të drejtpërdrejtë mbi qytetarët, për të rritur transparencën dhe përfshirjen e komunitetit.

3. Rritja e aksesit dhe ndërveprimit të qytetarëve. Përveç konsultimeve standarde, mund të krijohen mekanizma shtesë për mbledhjen e opinionit të qytetarëve (online, takime publike, anketa), duke siguruar që zëri i komunitetit të reflektohet realisht në vendimmarrje.

4. Monitorimi dhe raportimi i transparencës. Rekomandohet që raportet vjetore të transparencës të jenë të detajuara dhe lehtësisht të qasshme për publikun, duke përfshirë informacion mbi numrin e pjesëmarrësve në konsultime, temat diskutuar dhe ndikimin e sugjerimeve të qytetarëve në vendimet përfundimtare.

5. Trajnimi i stafit për integritet dhe konsultim publik. Punonjësit e bashkisë duhet të trajnohen rregullisht mbi procedurat e konsultimit publik dhe praktikat më të mira të integritetit, për të përmirësuar cilësinë e proceseve dhe besueshmërinë e administratës.

9. BARAZIA GJINORE

Përfundime:

Gjatë periudhës së raportimit, përqindja e grave në pozicione kyçe politike dhe administrative (kryetare, zv.kryetare, anëtare në këshill bashkiak dhe administratore) është përmirësuar nga 28.13% në 37.93%, një trend pozitiv me rritje prej 9.81 përqind, duke treguar një avancim pozitiv në përfshirjen e grave në vendimmarrje. Ky është një tregues i rëndësishëm i rritjes së përfaqësimit gjinor në nivelet më të larta të administratës dhe politikës lokale.

Ndërsa, përqindja e grave në pozicione drejtuese të ndryshme brenda bashkisë (të lartë, të mesme, të ulët) ka pësuar një rënie nga 55.56% në 41.67%, duke shënuar një trend në ulje prej 13.89 përqind, që tregon një përkeqësim të përfaqësimit gjinor në nivelet menaxheriale të administratës. Gjithashtu, Plani Vendor Veprimi për Barazinë Gjinore nuk është hartuar ende, që do të thotë se nuk ka një strategji të formalizuar për të adresuar çështjet e barazisë gjinore në institucion.

Rekomandime:

- 1. Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore .** Bashkia duhet të hartojë dhe miratojë një plan konkret me objektiva, aktivitete dhe afate kohore për të rritur përfaqësimin e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe administratës.
- 2. Rritja e përfaqësimit gjinor në pozicione drejtuese.** Pasi është vënë re një rënie në përqindjen e grave në pozicione menaxheriale, rekomandohet të krijohen politika të brendshme për promovimin e grave, si mentorime, trajnime udhëheqëse dhe programe të avancimit profesional.
- 3. Monitorimi dhe raportimi i progresit.** Të vendosen indikatorë të qartë për barazinë gjinore dhe të raportohet rregullisht mbi arritjet dhe sfidat, duke përfshirë statistika për të gjitha nivelet drejtuese dhe pozicionet kyçe politike.
- 4. Programet e trajnimit dhe zhvillimit të grave.** Organizimi i trajnimeve të specializuara për gratë në administratë dhe menaxhim, për të forcuar aftësitë udhëheqëse dhe për të siguruar konkurrencë të barabartë për pozicione drejtuese.
- 5. Inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje politike dhe publike.** Promovimi i iniciativave që rrisin pjesëmarrjen e grave në këshillin bashkiak dhe në pozicione udhëheqëse të larta, përmes politikave të përfshirjes dhe stimulimit të kandidatëve gra

10. INTEGRIMI

Përfundime:

Gjatë periudhës 2023–2024, bashkia ka ruajtur stabilitetin në disa tregues kyç. Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkuara ka mbetur 3 për të dy vitet si dhe krijimi dhe funksionimi i strukturave të performancës në bashki tregon për një konsolidim të strukturave përgjegjëse për performancën. Nga ana tjetër Bashkia ka hartuar dhe është duke zbatuar planet e migracionit dhe diasporës.

Vihet re nga të dhënat se komisionet e integritetit europian pranë këshillave bashkiakë nuk janë krijuar ende dhe sinjalizon për më shumë vullnet insitucional. Një problem i rëndësishëm vihet re në projektet e aplikuara kundrejt atyre të fituara dhe financuara nga Bashkimi European: përqindja e projekteve të fituara ka rënë nga 100% në 40%, një përkeqësim prej 60%, por duke qenë se për vitin 2023 janë raportuar si aplikime vetëm numri i projekteve fituese rezultojnë këta tregues.

Gjithashtu kjo tregon se bashkia ka pasur vështirësi në sigurimin e financimeve europiane për projektet e propozuara, duke treguar nevojën për forcim të kapaciteteve të strukturave të menaxhimit të projekteve dhe të praktikave të aplikimit për fonde ndërkombëtare.

Rekomandime:

- 1. Forcimi i kapaciteteve për aplikime dhe menaxhim projektesh.** Rekomandohet që stafi përgjegjës për shkrimin e projekteve të zhvillojë trajnime dhe asistencë teknike në hartimin, aplikimin dhe menaxhimin e projekteve europiane, me qëllim rritjen e shkallës së projekteve të fituara.
- 2. Rishikimi dhe përmirësimi i strukturave të performancës.** Edhe pse ekzistojnë, strukturat e performancës duhet të vlerësohen periodikisht për efektivitetin e tyre dhe për të identifikuar mundësi për rritje të efikasitetit në monitorimin e projekteve dhe shërbimeve.
- 3. Zgjerimi i marrëveshjeve ndërbashkiake.** Përtej ruajtjes së numrit aktual, rekomandohet identifikimi i partnerëve të rinj dhe forcimi i bashkëpunimeve ndërbashkiake për shkëmbim praktikash të mira dhe projekte të përbashkëta zhvillimi.
- 4. Krijimi dhe funksionimi i komisioneve të integritetit europian.** Krijimi i këtyre komisioneve pranë këshillave bashkiakë mund të përmirësojë koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve për integrimin europian dhe përdorimin e fondeve europiane.
- 5. Monitorimi dhe raportimi i progresit.** Vendosja e indikatorëve të qartë për suksesin e projekteve, efektivitetin e marrëveshjeve ndërbashkiake dhe funksionimin e strukturave të performancës, me raportim të rregullt për menaxhimin strategjik.

11. MENAXHIMI FINANCIAR

Përfundime:

Gjatë periudhës së raportimit, të ardhurat e veta për frymë janë rritur nga 4,974.72 në 5,947.01 lekë/person (+20%), duke treguar përmirësim në mobilizimin e të ardhurave të brendshme. Shkalla e përdorimit të të ardhurave ka shënuar një rënie drastike nga 829.60 % në 76.19%. Të dhënat tregojnë përdorim më pak të efektshëm dhe potencialisht ulje të kapaciteteve për shpenzime të planifikuara. Të ardhurat nga taksa e pasurisë gjithashtu kanë shënuar ulje modeste, nga 28.96% në 28.95% (-0.01%), duke ruajtur një kontribut të qëndrueshëm ndaj buxhetit vendor.

Nga ana tjetër, raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit ka rënë nga 125.84% në 13.27% (-112.57%), ndërsa buxheti i miratuar për frymë ka shënuar një rritje të lehtë nga 32,796.50 në 34,155.40 lekë/person (+4%). Ulja e konsiderueshme e të ardhurave të veta ndaj buxhetit tregon një dobësim të raportit të vetë-mjaftueshmërisë së bashkisë dhe potencialisht një varësi më të madhe nga transfertat qendrore. Investimet për frymë janë rritur ndjeshëm nga 6,605.84 në 9,519.40 lekë/person (+44%), duke përmirësuar peshën e investimeve në buxhet nga 20.14% në 27.87% (+38%), duke treguar prioritet në zhvillim dhe përmirësim të infrastrukturës. Megjithatë, pesha e detyrimeve financiare të papaguara ndaj të tretëve ka shënuar një rritje të lehtë nga 16.74% në 17.33% (+4%), që tregon nevojën për menaxhim më të kujdesshëm të borxheve

Rekomandime:

1. Forcimi i të ardhurave vendore. Për të rritur qëndrueshmërinë financiare, rekomandohet që bashkia të forcojë më tej mobilizimin e të ardhurave vendore përmes diversifikimit të burimeve dhe rritjes së kapaciteteve të administrimit fiskal. Duhet të investohet në përmirësimin e procedurave të mbledhjes së taksave, dixhitalizimin e shërbimeve dhe zgjerimin e bazës tatimore, veçanërisht për taksën e pasurisë. Paralelisht, sugjerohet hartimi i një strategjie shumëvjeçare për rritjen e të ardhurave të veta, me objektiva të matshëm dhe mekanizma monitorimi.

2. Përmirësimi i planifikimit buxhetor. Në drejtim të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, rekomandohet përdorimi i metodologjive më të avancuara të buxhetimit të bazuar në performancë për të përmirësuar saktësinë e projeksioneve buxhetore. Bashkia duhet të forcojë analizat e riskut financiar dhe të sigurojë që buxheti i miratuar të reflektojë nevojat reale të komunitetit dhe prioritetet zhvillimore. Përfshirja më e gjerë e publikut dhe transparenca më e lartë gjatë ciklit buxhetor do të kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies dhe besimit të qytetarëve.

3. Rritja e efektivitetit të shpenzimeve dhe investimeve. Sa i përket shpenzimeve dhe investimeve, rekomandohet përqendrim te projektet me impakt të lartë ekonomik dhe social, duke rritur cilësinë e vlerësimit të fizibilitetit dhe monitorimit të zbatimit. Rritja e investimeve është pozitive, por për të shmangur rreziqet financiare, është thelbësore ulja graduale e detyrimeve të prapambetura nëpërmjet kontrollit më të mirë të likuiditetit dhe disiplinës së pagesave. Forcimi i mekanizmave të menaxhimit financiar dhe auditimit të brendshëm do të mbështesë një administrim më të qëndrueshëm dhe efikas të buxhetit vendor.

PËR NJËSIMIN E PERFORMANCËS

DREKTORI FINANCES

R. ZARF VOGEL
